

VENDIM
Nr. 542, datë 8.7.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË
PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË
PUNËS, PËR TË TRANSFERUARIT BREnda NDËRMARRJES, TË TIPIT
“A/TN”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit “A/TN”, si i transferuar brenda ndërmarrjes/shoqërisë, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një marrëdhënie pune me shoqërinë tregtare që e transferon përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 89, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, të paktën për një periudhë 6-mujore, të pandërprerë për “administrator” dhe “specialist”, si dhe 3-mujore të pandërprerë për “praktikant të diplomuar”, që paraprin menjëherë këtë transferim;

b) ka kualifikimin profesional dhe përvojën e nevojshme në shoqërinë tregtare/degën e shoqërisë së huaj, në të cilën ai ose ajo do të transferohet si administrator ose specialist, ose në rastin e një “praktikanti të diplomuar”, gradën universitare të kërkuar;

c) kryen detyrat, ka njohuritë dhe plotëson kushtet sipas përcaktimeve të dhëna në nenet 3 e 89, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;

ç) ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastin kur kërkesa paraqitet nga vetë i huaji në zyrën e punës;

d) paraqet një dokument të vlefshëm udhëtimi, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt në Republikën e Shqipërisë;

dh) paraqet dokumentacionin përkatës që vërteton se dega ose zyra e përfaqësimit dhe shoqëria tregtare e themeluar në një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë i përkasin të njëjtës shoqëri tregtare ose grupi shoqërish;

e) vërteton se në fund të periudhës së transferimit do të transferohet në një degë që i përket shoqërisë tregtare ose grupit të shoqërive të vendosura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ë) përmbush kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për të ushtruar profesionin e rregulluar;

f) ka paraqitur kërkesë për t’u siguruar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

g) deklaron vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të punëmarrësit të huaj të transferuar, në përputhje me ligjin “Për gjendjen civile”.

2. Kërkesa për t’u pajisur me leje pune të tipit “A/TN” bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, pranë të cilit i huaji transferohet brenda ndërmarrjes/shoqërisë.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 2014/66/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 15 majit 2014, mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L 157/1, datë 27.5.2014.

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) kopjen e aktit të njohjes së personalitetit juridik të ndërmarrjes/shoqërisë mëmë, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

c) kopjen e kontratës së punës, të lidhur me shoqërinë tregtare mëmë, ku të vërtetohet se ka një periudhë pune jo më pak se 6 muaj të pandërprerë për “administrator” dhe “specialist”, si dhe 3-mujore të pandërprerë për “praktikant të diplomuar”, në këtë shoqëri tregtare, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

ç) deklaratën e transferimit brenda shoqërisë nga punëdhënësi i huaj, sipas nenit 90, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar;

d) certifikatën dhe dëshminë për njohuritë e specializuara, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

dh) kopjen e pasaportës;

e) tri fotografi;

ë) dokumentacionin përkatës, sipas ligjit kombëtar për ushtrimin e profesioneve të rregulluara, në rast se aktiviteti që do të ushtrojë shtetasi i huaj është një profesion i rregulluar;

f) kërkesën e paraqitur në institucionet përkatëse për t’u siguruar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

g) kontratën e qirasë (kopje) ose dokument ekuivalent me të, që tregon adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të punëmarrësit të huaj të transferuar;

gj) dokumentacionin që vërteton pagesën e tarifës së përcaktuar në pikën 13, të këtij vendimi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, aplikojnë *on-line* përmes shërbimit elektronik në portalin qeveritar *e-Albania*, duke paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i drejtohet zyrës përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës subjekti, pranë të cilit do të transferohet, ushtron veprimtarinë ekonomike, dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në nivel qendror, nëse subjekti, pranë të cilit do të transferohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

6. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, pajis të huajin, me leje pune të tipit “A/TN”, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, sipas formatit të dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e aplikimit, shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe nëse vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 3, të këtij vendimi, i kërkon të huajt plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajt, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi.

9. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, verifikon shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

10. Të huajt i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit “A/TN”, kur dokumentacioni nuk është i plotë edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, dhe/ose nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

11. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit “A/TN”, ka të drejtën e ankimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 81, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

12. Leja e punës e tipit “A/TN” përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

13. I huaji, i cili pajiset për herë të parë me leje pune të tipit “A/TN”, para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

14. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në ministrinë e përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës.

15. Vendimi nr. 85, datë 12.2.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës të tipit ‘A/TN’”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen ministria përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË



DREJTUAR: AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TO: NATIONAL AGENCY OF EMPLOYMENT AND SKILLS

ZYRËS SË PUNËSIMIT
EMPLOYMENT OFFICE

për lëshimin e lejes së punës një të huaji/for issuance of work permit to a foreigner

1. Emri i punëdhënësit _____
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit _____
 Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH |_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|_|
Registration number in the Cr Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NIPT |__|__|__|__|__|_____|*OIB*|_|__|__|__|__|__|__|__|_|_____|
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or _____

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit: _____
Abstract from National Biznes Centre

5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës |__|__|__|__|__|__|_____|_____| deri në
|__|__|__|__|__|__|__|__|
Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position

7. Kuotat vjetore	<i>PO</i>	<i>JO</i>
Yearly quota	<i>YES</i>	<i>NO</i>

8. Punësimi sezonal	<i>PO</i>	<i>JO</i>
Seasonal employment	<i>YES</i>	<i>NO</i>

9. Migrimi ditor	<i>PO</i>	<i>JO</i>
Daily migration	<i>YES</i>	<i>NO</i>

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT/INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname

2. Emri _____
Given name(s)

3. Emri i babait _____
Name of the parent

4. Datëlindja |__|__|__|__|__|__|__|__|
Date of birth

5. Gjinia **F** **M** |__|__|__|__|__|__|__|__|
Sex **M** **F** * to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth

7. Shtetësia _____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit |__|__|__|__|__|__|__|__|
Code and name of occupation

10. Kualifikimet |__|__|__|__|
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës **PO** **JO**
Gainfully employed **YES** **NO**

3. DOKUMENTI I VLEFESHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri |.|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|__|
Number

3. Lëshuar në |__|__|__|__|__|__|__|__|
Issued on

4. E vlefshme deri më |__|__|__|__|__|__|__|__|
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)

ANEKS 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

Nr. ____ prot.
Datë

LEJE PUNE PËR TË HUAJT
TIPI: A/TN

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr., datë _____.2020, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për të transferuarit brenda ndërmarrjes, të tipit “A/TN”,

Z./znj.
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s)
Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më
____Born on(data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In _____ (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____|____|____|____|____|____|____|____|____|____|

Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit A/TN, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin 89, të ligjit nr.108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj: Name of the employer

Statusi i subjektit: _____
(Subject's Legal Status)

Sektori i aktivitetit: (Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: (Work Permit Validity)

Data e lëshimit: (Issuance Date) _____

Data e skadimit: (Expiration Date) _____

Pagesa: (Application Fee) _____

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.

Institucioni lëshues: _____ **(Issuing Authority)**